

**GREEN COAST SH.P.K.**

**RRUGA "TISH DALJA", KOMPLEKSI KIKA 2, GODINA 3, KATI 1., TIRANE, SHQIPËRI**

**L41329038D**

**VENDIM**

**I**

**ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË**

Sot, më 02.07.2024, në orën 10.00, në selinë e Shoqërisë **Green Coast Sh.p.k.** (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

- **Shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar pranë Regjistrat Tregtar me numër unik të identifikimit të subjektit K72223031K, përfaqësuar rregullisht nga Znj. Edlira MUKA, shtetase shqiptar, lindur më datë 03.02.1983, në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. 0342771384 (dhe me nr. Personal: I35203147R), madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ( këtu e në vijim referuar si "**Ortaku i Vetëm**"),

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Z. Bers Hado, këshilltar ligjor i shoqërisë, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

**RENDI I DITËS**

**I. ZMADHIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË**

\*\*\*\*\*

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtroi se kapitali aktual i Shoqërisë është **4,824,695,328 LEK (Katër miliard e tetëqind e njëzet e katër milion e gjashtëqind e nentëdhjetë e pesë mijë e treqind e njëzet e tetë lekë)**.

Me qëllim zhvillimin e projektit MGallery Hotel ka lindur nevoja e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë. Është vlerësuar e përshtatshme zmadhimi i kapitalit me 4,000,000 Euro (katër milion Euro) e konvertueshme me 401,120,000 (katërqind e një milion e njëqind e njëzet mijë lekë) sipas kursit të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë të datës e mbajtjes së kësaj Mbledhje (1 euro = 100.28 Leke)

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja

**VENDOS:**

- A. Miratimin e zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë me vlerën **4,000,000 Euro (katër milion Euro)** e konvertueshme me 401,120,000 (katërqind e një milion e njëqind e njëzet mijë lekë) sipas kursit të këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë të datës dhe ores së mbajtjes së kësaj Mbledhje (1 euro = 100.28 Lekë);
- B. Bazuar në sa më sipër zmadhimi i kapitalit do të konsiderohet Kontribut në Para dhe i shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.

C. Si rezultat i miratimit të Zmadhimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B) më sipër, kapitali i Shoqërisë nga është 4,824,695,328 LEK (Katër miliard e tetëqind e njëzet e katër milion e gjashtëqind e nentëdhjetë e pesë mijë e treqind e njëzet e tetë lekë) do të bëhet 5.225.815.328 LEK (pesë miliard e dyqind e njëzet e pesë milion e tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e njëzet e tetë Lekë).


\*\*\*\*\*

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 10.30.

Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "Green Coast" sh.p.k mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

**ASAMBLEË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË  
GREEN COAST SH.P.K.**

**KRYETARI**

  
Znj. Edlira MUKA



**SEKRETARI**

  
Z. Bers Hado